

ERIKETA KAMBO

**SHKOLLA SHQIPTARE NË FILLIMET
E “REVOLUCIONARIZIMIT”
(1966-1967)**

Duke filluar nga mesi i viteve '60, në shkollën shqiptare u iniciua një reformë e re. I gjithë sistemi arsimor iu nënshtrua ndryshimeve të rëndësishme, ku pjesa më e qenësishme lidhej me përmbajtjen, gjë që i dha edhe ngjyrimin periudhës. Krahasuar me reformat e mëparshme, ajo do të ishte një vazhdim i mëtejshëm i tyre. *E reja konsistonte në strategjitë e hartuara nga shteti totalitar, që bëhen më agresive dhe më të vendosura për të thelluar karakterin socialist të shkollës.* Parë nga ky këndvështrim “ndryshimet” marrin karakter gjithëpërfshirës, duke prekur çdo qelizë të procesit mësimor-edukativ, i cili iu nënshtrua një “rishikimi” të plotë nga prizmi i filozofisë marksiste-leniniste.

Tashmë është një fakt i njohur që arsimit shqiptar i Pasluftës së Dytë Botërore, ishte i orientuar ideologjikisht. Shqetësimi i përhershëm i udhëheqjes së vendit mbetej çështja se, çfarë brezi të ri përgatiste shkolla, dhe a e përmbushte si duhej ajo funksionin e saj “të edukimit komunist” të rinisë. Edukimi në vetvete përfaqëson një fushë me diapazon të gjerë ku operojnë shumë faktorë si institucionet shtetërore, organizatat politike e shoqërore, familja e mbarë shoqëria. Gjithsesi në shkallë të fundit, vendi parësor i takon shkollës dhe në këtë kuptim, ajo mban peshën kryesore.

Procesi i edukimit komunist në Shqipëri, ishte bërë i detyrueshëm, i pandërprerë dhe si i tillë mbeti i pakthyeshëm, deri në rënien e plotë të sistemit në vitet 90-të. Nëpërmjet tij u synua përfshirja gjithnjë e më e madhe e rinisë sidomos asaj shkollore, në ndërtimin e “shoqërisë së re” dhe “të njeriut të ri”. Në këtë kuadër, reforma “Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës” do të luante një rol të rëndësishëm. Në kushtet e një artikulli ku mundësitë për të rrokur të gjithë problematikën mbeten të kufizuara, *duket me interes përqendrimi në analizën e dy prej aspekteve më kryesore të kësaj faze të parë, në atë të klimës në të cilën u përgatit reforma dhe të reagimit të faktorëve të rëndësishëm, mësuesve dhe nxënësve.*

1 - Krijimi i klimës së ndryshimeve

Vitet 1966-1967 përfaqësojnë fazën përgatitore për reformën e re arsimore, gjatë së cilës u hodh ideja e realizimit të saj. Nga pikëpamja e zhvillimit të përgjithshëm ajo përkon me periudhën e fundit të pesëvjeçarit të tretë, që u shoqëruan me ndryshime të rëndësishme për ecurinë ekonomike dhe shoqërore të vendit. Pavarësisht nga ç'ka deklarohet, kjo reformë u iniciua dhe u realizua gjatë një periudhe të vështirë, që kërkoi privacione të tjera nga pjesa më e madhe e popullsisë. Klima e disfavorshme ndërkombëtare pas prishjes me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të Bllokut Komunist, me gjithë përpjekjet e udhëheqjes për të zbutur impaktin negativ mbi ekonominë, nuk kaloi pa pasoja. Kreditë e marra nga këto të fundit, përbënin fondin e nevojshëm bazë për zhvillimin e industrisë dhe të bujqësisë dhe për rrjedhojë, ndërprerja e menjëhershme dëmtoi rëndë realizimin e investimeve të rëndësishme në ekonomi.

Nga analiza e shifrave të publikuara, të marra këto si të mirëqëna rezultonte se, në vitin 1965 prodhimi i përgjithshëm industrial zinte 56,6 për qind të prodhimit të përgjithshëm, me një rritje mesatare vjetore prej 6,8 për qind. Prodhimi bujqësor ishte vetëm 36 për qind më i lartë në raport me vitin 1960, duke mos përmbushur parashikimet për shtimin e prodhimit bujqësor e atij blegtoral¹. Ekonomia zhvillohet gjithnjë sipas skemave të vjetra e të pandryshuara, në bazën e të cilave qëndronin konceptet ideologjike që i jepnin përparësi zhvillimit të industrisë së rëndë dhe sidomos, asaj nxjerrëse dhe përpunuese. Investimet në “veprat e mëdha” thithën pjesën më të mirë të burimeve financiare të vendit, duke thelluar edhe më tej disproporcionin midis degëve të ndryshme të kësaj ekonomie të centralizuar.

Ndonëse në pamjen e parë u duk sikur ndryshimet për reformimin e sistemit komunist të nisura në Vendet e Lindjes nuk e prekën Shqipërinë, në mënyrë të tërthortë ato ushtruan presion mbi PPSH. Tepër refraktare ndaj çdo orvatje për korrigjime në “vijë”, kjo e fundit ndërmori politika shtrënguese dhe masa drastike, që e çuan vendin drejt mbylljes dhe izolimit.

E nisur nga motive politike dhe e kushtëzuar nga kriza ekonomike e financiare ajo ndërmori një varg ndryshimesh që fillimisht prekën

¹ *Historia e Shqipërisë*, vëll.4, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1983, fl. 304-305.

administratën. Ato u inkuadruan në atë që u quajt “Lufta kundër burokratizmit dhe ndikimeve të tjera të ideologjisë së huaj”. Në dy mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH, mbajtur në dhjetorin e vitit 1965 dhe janarin e vitit 1966, u përvijuan linjat e një strategjie të re që kish si objekt, riorganizimin e administratës dhe lehtësimin e saj nga shpenzimet e tepërta. Në thelb ajo synonte para së gjithash spastrimin nga njerëzit “e papërshtatshëm” dhe “mosbesues ndaj politikës së PPSH”².

Masat e marra në këtë kuadër i paraprinë atij procesi të gjatë, intensiv dhe stresant për shumicën e popullsisë, “për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit”, që çoi në politizimin e tejskajshëm të të gjitha aspekteve të veprimtarisë ekonomike e shoqërore. Në kushtet e forcimit të diktaturës së proletariatit, çrënjosja e shtrembërimeve dhe shfaqjeve burokratike, që sipas konceptit të udhëheqjes komuniste, ishin “shprehje e presionit të armikut të klasës dhe të ideologjisë së tij”³ mbi partinë dhe aparatit shtetëror, do të çonin më tej fitoret e arritura. Në këtë kontekst, u intensifikuan përpjekjet për ndryshime “radikale” në gjithë sistemin e drejtimit, duke kërkuar nga punonjësit, si do të thuhej në një letër “të hapur” të KQ të PPSH drejtuar masave në marsin e vitit 1966 që, në punën dhe jetën e tyre të udhëhiqeshin nga parimi i vënies gjithnjë “të politikës proletare në plan të parë” dhe që “çdo problem të gjykohej para së gjithash politikisht”⁴.

Në klimën e krijuar mjaft zyrtarë, u detyruan të largohen nga vendi i tyre i punës, për të punuar në “bazë” apo drejtpërsëdrejti në prodhim. Administrata qendrore dhe lokale u tkurrën ndjeshëm. Me një vendim të posaçëm të Qeverisë, të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e sferave të arsimit, kulturës, shkencës, për të qenë më afër “masave” dhe njohur jetën e tyre, do të punonin çdo vit nga një muaj në prodhim kryesisht në fshat dhe nxënësit, studentët e pedagogët do të jepnin “kontributin” e tyre në aksionet kombëtare e lokale. Në gjithë këtë proces për “revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit” qëllimi i vërtetë i PPSH ishte “të pastronte shoqërinë shqiptare nga prirjet josocialiste, të

² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.IV, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2008, f. 284.

³ *Po aty*, f. 312.

⁴ *Dokumente Kryesore të PPSH*, vëll. V, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 nëntori”, 1974, f. 34.

shkurtonte burokracinë dhe të vigjilonte mbi partinë kundër çdo degjenerimi revizionist”⁵.

Procesi u thellua sidomos pas fjalës së mbajtur nga E. Hoxha në 6 shkurt 1967, ku kërkohej që “lufta kundër burokratizmit e ngritur në plan politik-ideologjik, të bëhej me vendosmëri e ashpërsi në të gjitha drejtimet, për të çrrënjësuar konceptet e huaja, për të spastruar shoqërinë socialiste nga mbeturinat e së kaluarës”⁶. Ky ishte edhe një moment kulmor i thellimit të atij që u quajt “revolucioni ideologjik e kulturor”, ku shkolla zinte një vend të rëndësishëm. Sipas pikëpamjes të shumë autorëve perëndimorë në 6 shkurt 1967, Enver Hoxha e reklamoi “revolucionarizimin”, si do të evidentonte njëri prej tyre Thomas Schreiber, “si një erë e re në parti dhe në shtet”. Ai kërkoj “që klasa punëtore, baza ta ushtronte gjerësisht dhe me efikasitet të drejtën e saj të kritikës kundër njerëzve të pushtetit” (funksionarëve) “ky diskutim do të jepte sinjalin e një minirevolucioni kulturor shqiptar”⁷.

E gjejmë me vend që të hapim një parantezë lidhur me këtë çështje. Tashmë është e njohur dhe pranuar si nga historiografia perëndimore ashtu edhe ajo shqiptare e pas viteve 90-të se, në këtë proces një ndikim të drejtpërdrejtë ushtroi influenca e Revolucionit Kulturor Kinez. “Gjatë gjithë viteve gjashtëdhjetë - do të pohonte në punimin e tij “Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona” studiuesi Antonello Biagini, - politika shqiptare frymëzohet nga modeli kinez deri në atë pikë, sa midis viteve 1965 dhe 1969 importohet i ashtuquajtur i revolucionit kulturor”⁸. Sipas një autori tjetër perëndimor “Në këtë kohë Shqipëria për të mos ngelur mbrapa modelit të saj kinez, donte të bënte revolucionin e saj kulturor të quajtur “revolucionarizim”⁹.

Duke analizuar synimet e udhëheqjes komuniste, njohësi i mirë i çështjeve shqiptare Elez Biberaj, gjatë analizës së këtij procesi do të tërhiqte vëmendjen se, “Më 1966 Enver Hoxha filloi versionin e vet të Revolucionit Kulturor të Kinës, me qëllim që të eliminonte çfarëdo

⁵ Joseph Rothschild, *Kthim në Diversitet*, Tiranë: “Onufri”, 1998, fl. 200.

⁶ *Historia e Shqipërisë*, vëll. IV, f. 326.

⁷ Thomas Schreiber, *Enver Hodja (Le sultan rouge)*, Paris: Shtëpia Botuese “Jolattès”, 1994, f. 188-189.

⁸ Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2000, f. 60.

⁹ Elisabet e Zhon Pol Shanse, *Shqipëria ose logjika e dëshpërimit*, Tiranë: Shtëpia e librit dhe e Komunikimit, 2000, f. 60.

qendre pushteti të mundshëm që të vinte në rrezik përparësinë e Partisë së Punës. Kjo dhe masa të tjera shkaktuan mjerim dhe rrëmuje në të gjithë vendin. Me pretekstin e luftës kundër traditave rrënjëthella të konservatorizmit në shoqëri që ishin të papajtueshme me idetë komuniste, regjimi filloi një fushatë të bashkërenditur kundër zakoneve tradicionale, besimeve fetare dhe atyre që ai zyrtarisht i quante ndikime të huaja”¹⁰.

Udhëheqja shqiptare u tregua e kujdesshme në trajtimin e këtij problemi, duke mos pranuar apo duke minimizuar ndikimin në të, të revolucionit kulturor kinez. Në tekstin “Historia e PPSH” botimi i vitit 1968, nuk gjendet as një prononcim që të çon në përfundimin se lëvizjet “revolucionarizuese” të këtyre viteve ishin imitimi i revolucionit kulturor kinez, në kundërtënie me mendimin se ishte pikërisht që, gjatë periudhës së “miqësisë së përyetshme Kino-shqiptare” që u hodhën dhe u zbatuan direktivat e mëdha të Enver Hoxhës, lidhur me revolucionarizimin e jetës, të shkollës, të spastrimit të teksteve, të gjykatave popullore lidhur me shkurtrimin e kopshteve personale, luftën kundër fesë, vigjilencën revolucionare” etj.¹¹.

Në tekstin zyrtar “Historia e Shqipërisë”, vëll. 4, botim i vitit 1983 kur marrëdhëniet me Kinën janë prishur pranohet se, PPSH mbrojti popullin kinez “kur mbështeti Revolucionin kulturor”, por që rezultoi “një luftë për pushtet midis grupeve (reaksioniste dhe antimarksiste” dhe që si i tillë, sipas përcaktimit të vetë Enver Hoxhës “nuk ishte as revolucion, as i madh, as kulturor dhe sidomos aspak proletar”¹². Nuk mund të mohohet se ekzistonin rezerva për disa anë apo parulla të këtij revolucion si, “t’i biem shtabit” etj., që nënkuptonin udhëheqjen më të lartë dhe vetë liderin. Por njëheri nuk duhet anashkaluar fakti që, në shumë aspekte praktikat ekstremiste të huazuara nga ky revolucion u transplantuan mekanikisht në ambientin shqiptar, duke sjellë pasoja të rënda që ndikuan fuqishëm në ecurinë e mëtejshme të vendit .

Vite më vonë Ramiz Alia do të pranonte se “Ka një paradoks këtu. Ne si udhëheqës nuk përkrahim konceptet e “revolucionit kulturor”

¹⁰ Elez Biberaj, *Shqipëria në tranzicion – Rruga e vështirë drejt demokracisë*, Tiranë: “Ora”, 2000, f. 49.

¹¹ Emil Genar, *E paharueshmja, Shqipëri – Kujtime të një kohe të vështirë 1966-1968*, Tiranë, 1996, f. 30.

¹² *Historia e Shqipërisë*, vëll.IV, f. 391 dhe Enver Hoxha, *Imperializmi dhe revolucioni*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1978, f. 384.

kinez. Nuk përkrahim sektarizmin, punën e citateve të Maos, qëndrimin në kulturë ndaj klasikëve të qytetërimit etj. Domethënë ne nuk ishim dakord. Por paradoksi në fakt është se, me gjithë se nuk ishim dakord, në një mënyrë apo tjetër, ne i morëm këto konceptione ose u frymëzuam nga masat e “revolucionit kulturor”¹³. Nuk mund të thuhet me siguri se sa i sinqertë është ky pohim, por është fakt që, shoqëria shqiptare e përjetoi këtë “revolucion” dhe rrjedhojat e tij, padyshim që nuk kaluan pa pasoja.

Gjithsesi në vija të përgjithshme, shumica e studiuesve që i kanë prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çështjet e revolucionit kulturor, ndajnë të njëjtin mendim lidhur me format dhe përmasat që ai mori në Shqipëri. “Varianti shqiptar sipas njërit prej tyre, i “revolucionit kulturor” ndryshe nga ai kinez, nuk doli kurrë jashtë kontrollit të partisë, nuk stimuloi momente të shpërthimeve spontane që të shpinin në dhunë kolektive, poshtërime publike ose përçarje ekonomike”¹⁴. Emil Gënar, diplomat francez i ndodhur në këto vite në Shqipëri, në kujtimet e tij do ta përshkruante këtë proces si një lëvizje që, vërtet nuk mori “përmasat dhe karakterin e çrregulluar dhe të përgjakshëm që mori në Kinë se, kurrë nuk u panë në rrugët e Tiranës si në Pekin, kortezhe të “armiqve të popullit”, por “këtu lufta ishte më spektakolare” dhe “po aq radikale, sepse Partia ruajti gjithmonë kontrollin mbi “spontanitetin” e operacioneve”¹⁵.

Në vorbullën e këtij “revolucionit” shkolla si institucioni bazë i edukimit padyshim u gjend e përfshirë. Që në dhjetorin e vitit 1965, Enver Hoxha në fjalën e mbajtur para nxënësve të gjimnazit “Qemal Stafa” në Tiranë, do të fokusohet në problemet që qëndronin para rinisë shkollë, duke kërkuar më tepër angazhim dhe pjesëmarrje në zgjidhjen e tyre¹⁶. Sigurisht këto çështje nuk ishin të reja, por evidencimi i tyre parë nga këndvështrimi i zhvillimeve të mëvonshme, mbështet faktin se “sinjali” për rishikimin “kritik” të të gjithë veprimtarisë mësimore edukative, ishte dhënë. Çështjet e forcimit të karakterit socialist të shkollës dhe e luftës kundër çdo ndikimi burokratik në jetën e saj, filluan të evidencohen gjithnjë e më me forcë.

¹³ Ramiz Alia, *Unë Ramiz Alia dëshmoj për historinë*, Tiranë: “Dituria”, f. 66.

¹⁴ J. Rothschild, *Kthim në Diversitet ...*, f. 200.

¹⁵ E. Genar, *E paharueshmja ...*, f. 30.

¹⁶ Enver Hoxha, “Të revolucionarizojmë marrëdhëniet mësues-nxënës dhe metodat e mësimin”, Fjala e mbajtur në gjimnazin “Qemal Stafa” në Tiranë, dt. 29 dhjetor 1965, në *Vepra*, vëll. 30, Tiranë: “8 Nëntori”, 1980, f. 560.

Në prag të reformës shkolla shqiptare kishte njohur disa arritje. Kështu në fushën e masivizimit treguesit kishin shënuar rritje relative. Në vitin 1965 në krahasim me 1960, u shtuan 165 shkolla fillore dhe numri i nxënësve arriti në 240.000. Arsimi 7-vjeçar dhe më vonë ai 8-vjeçar i detyruar, njohën një zgjerim të mjaftueshëm, sidomos në fshatrat malore dhe zonat e thella, ku u ndërtuan edhe 212 shkolla të reja. Në këto kategori arsimore, rezultoni të përfshirë afërsisht 88 për qind e nxënësve që përfundonin arsimin fillor¹⁷. Përmirësime u dukën edhe në arsimin e mesëm, sidomos në atë profesional, ku u shtuan 37 shkolla si dhe në arsimin e lartë. Në gjithë sistemin shkollor mësonin 425.000 nxënës dhe studentë. Sasia e specialistëve gati u dyfishua, duke arritur në 9200 specialistë me arsim të lartë dhe 22.500 me arsim të mesëm¹⁸.

Ndryshime jo të pakta solli edhe implementimi i reformës të vitit 1963 për “Riorganizimin” e gjithë sistemit arsimor shqiptar. Motivet që e shtynë udhëheqjen e vendit në ndërmarrjen e masave të reja, mbeteshin politike. Njëpërmjet saj u synua para së gjithash, përshtatja më e mirë e sistemit shkollor ekzistues, nevojave të ekonomisë dhe kulturës të një shoqërie socialiste në konsolidim. Në thelb ato përfaqësonin edhe një domosdoshmëri për ta bërë këtë sistem më elastik. Gjithsesi, me zbatimin praktik të reformës për riorganizimin e shkollës, u hasën vështirësi të shumta dhe pavarësisht asaj çka thuhej, analiza e dokumentacionit të kohës mbështet faktin se i gjithë sistemi i edukimit manifestonte defekte e mangësi. Sipas opinionit të vetë strukturave arsimore, ndonëse pranohej në parim se riorganizimi ishte një reformë e shtruar “drejt”, rezultatet e saj linin për të dëshiruar. “Korniza ende e ngushtë e sistemit arsimor, do të pohohej në një prej burimeve të brendshme, sidomos në arsimin e mesëm dhe atë të lartë përbënin një pengesë për një shkollim masiv”¹⁹. Domethënës ishte fakti që, rrjeti i shkollave të mesme të përgjithshme dhe ai i të ulëtave e të mesme profesionale, në kushtet kur pretendohet për arsimim të gjerë sidomos të rinisë punëtore dhe asaj fshatare, ishte i pamjaftueshëm.

Përpos kësaj, me gjithë përpjekjet e bëra, shkolla shqiptare mbetej ende e rënduar me lëndë teorike dhe e mbingarkuar, duke dhënë një

¹⁷ *Arsimi Popullor*, viti 1966, nr. 5, fl.4.

¹⁸ *Historia e Shqipërisë*, vëll. 4, f. 298.

¹⁹ Mehmet Shehu, Raport i mbajtur në Byronë Politike të të KQ të PPSH “Mbi konkluzionet e diskutimit për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë”, në: *Arsimi Popullor*, viti 1969, nr. 4, f. 24-25

edukatë të njëanshme mendore dhe krijuar boshllëk në formimin e përgjithshëm të nxënësve²⁰. Në organizimin e punës mësimore-edukative aplikoheshin përgjithësisht metoda tradicionale, disi të vjetruara apo të mbartura mekanikisht nga shkolla sovjetike. Stili i punës edukative, vuante nga verbalizmi i shfaqur dukshëm në zyrtarizimin e marrëdhënieve mësues – nxënës, në formën e tutelës apo të indiferentizmit. Me zbatimin e reformës për “Riorganizimin e sistemit arsimor” të vitit 1963, kishte filluar një “lëvizje” për gjetjen e formave dhe metodave të reja që i jepnin më tepër rëndësi lidhjes së teorisë me praktikën, aktivizimit të nxënësve në punë të pavarur, duke tentuar shmangien e skematizmit në orën e mësimit. Por e gjithë kjo do të rezultonte e pamjaftueshme.

Mangësitë e defektet në sistemin arsimor të deriatëhershëm, natyrisht u panë nga këndvështrimi i shtetit komunist. I përballur me probleme të shumta në këtë fushë, ndonëse me gjysëm zëri, ai është i detyruar t’i pranonte por, anashkalon arsyet e vërteta që lidheshin me vetë përmbajtjen e sistemit arsimor të ngritur. Përpos rrethanave objektive dhe mungesës së përvojës konsiderohej se, një ndikim negativ, kishte luajtur shikimi “administrativ dhe burokratik” i problemit, “shuarja e entuziazmit të parë” me të cilin u nis reforma, “standardizimi” dhe “skematizmi i programeve, metodave dhe formave të përdorura”²¹. Si do të pohohej nga vetë ministri i atëhershëm i Arsimit, Th. Deljana, nuk ishte luftuar sa duhej për krijimin e një opiniononi “të shëndoshë” dhe “të qartë”. Propaganda jonë do të konfirmonte ai, ishte e “dobët” dhe “disa sllogane stereotipe të kopjuara më shumë nga jashtë, s’patën efektin e duhur dhe në fakt, shkolla jonë nuk pësoi ndryshim cilësor nga shkolla e vjetër”²².

Po aq i rëndësishëm konsiderohej fakti që thelbi i reformës për riorganizimin e sistemit arsimor, lidhja e mësimit me punën, i teorisë me praktikën realizohej dobët. Mësimi i punës shpesh trajtohej si shtojcë mekanike lëndësh në planin mësimor, ku preokupimi kryesor ishte pjesëmarrja në prodhim, duke anashkaluar “vlerat edukative”. E gjithë kjo situatë justifikohej me vështirësitë e rritjes, ku padyshim faktorët objektivë kishin peshën e tyre. Por ajo çka realisht kushtëzonte ecurinë e

²⁰ *Po aty*.

²¹ Hasan Duma, “Të forcojmë edukatën e punës në shkolla si mjet për të edukuar një brez të ri revolucionar”, në: *Arsimi Popullor*, viti 1960, nr. 5, f. 42.

²² Thoma Deliana, “Për një metodë dhe stil revolucionar në punën arsimore-kulturore”, në *Arsimi Popullor*, viti 1966, nr. 3, f. 39-40.

shkollës në fund të fundit ishin politikat e ndjekura nga shteti për shkollën.

Në nëntorin e vitit 1966 zhvilloi punimet Kongresi i V i PPSH, i cili përpunoi, përpos të tjerave edhe, linjat kryesore të zhvillimit të ardhshëm arsimor të vendit. Ato shërbyen si baza e platformës së ndryshimeve “radikale” në këtë fushë. Ndonëse problemet kryesore të masivizimit të shkollës ishin futur në rrugën e zgjidhjes, zgjerimi i mëtejshëm i arsimit mbetej pjesë e tyre. Arsimi fillor pritej të shtrihej në përputhje me nivelin e rritjes natyrore të popullsisë. Në arsimin 8-vjeçar synohej dyfishimi i numrit të nxënësve, bazuar në faktin e daljes të kontigjenteve të para nga klasat e larta të saj dhe e shtimit të atyre që përfundonin shkollën fillore. Për të zbutur shpërpjesëtimet midis zonave dhe rajoneve të ndryshme të vendit, parashikohej ndërtimi i 200 shkollave të reja 8-vjeçare. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve pritej të arrinte nga 425.000 në vitin 1965 në, 542.000 në vitin 1970 dhe ai i specialistëve, nga 9200 në 15.350, specialistë të mesëm dhe të lartë²³.

Si prioritet i së ardhmes, do të përcaktohej thellimi i mëtejshëm i karakterit socialist të shkollës dhe vendosja gjithnjë e më e plotë e strukturave mësimore – edukative, mbi bazat e teorisë marksiste-leniniste. “Sigurisht shoqërisë sonë socialiste, - do të tërhiqej vëmendja në punimet e Kongresit V-të të PPSH, - i duhet ai arsim që i përgjigjet detyrave të edukimit të masave dhe sidomos të rinisë, me frymën klasore revolucionare”²⁴. Shkolla tashmë duhej të luante një rol edhe më aktiv për përgatitjen e kësaj rinie, “të brumosur me ideologjinë marksiste-leniniste” dhe të gatshme për të mbështetur “totalisht” PPSH në politikat e saj.

Forcimi në të gjitha aspektet i partishmërisë dhe tendenciozitetit klasor të shkollës, presupozonte thellimin më tej të procesit të edukimit komunist të rinisë. Me gjithë ndryshimet e realizuara, sipas këndvështrimit të udhëheqjes së vendit shkolla vijonte të kishte “dobësi” dhe “zbrazëti” që konsistonin sidomos, në mos theksimin sa duhej të “tendenciozitetit ideopolitik klasor revolucionar”, në mungesën e “një lidhjeje organike dhe në shkallën e duhur të mësimit dhe edukimit me aktualitetin”, që në vija të përgjithshme, nuk ishte arritur stabiliteti i

²³ “Para jubileut të madh”, në: *Arsimi Popullor*, viti 1966, nr. 5, fl. 9.

²⁴ *Kongresi V-të i PPSH (Përmbledhje materialesh)*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1966, f. 151.

veprimtarisë mësimore-edukative në atë shkallë që, të përmbushte “kërkesat e reja”²⁵ etj. Kongresi përvijoi linjat e para teorike të reformës se re “Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës”, që evoluoi doradorës. Ajo u konceptua si një proces i gjerë dhe i thellë ndryshimesh, që do të përfshinte “vetë sistemin arsimor, brendinë dhe metodat e mësimin dhe edukimit”²⁶.

Në shkallë të fundit, ecuria e ndryshimeve përpos të tjerave do të kushtëzohej nga fakti se, çfarë lejonte niveli i zhvillimit ekonomiko-shoqëror i vendit në përgjithësi dhe, ai arsimor e kulturor në veçanti. Për të nisur në këto momente një ndërmarrje kaq të gjerë mbetej i rëndësishëm edhe fakti se, sa e përgatitur ishte vetë shkolla për zhvillimet e pritshme. Pyetjet dhe dilemat ishin të shumta. Krahas qëndrimit uniform aprovues që ishte dominues, tentohet për një mendim disi më ndryshe. Gjithsesi, në kushtet e një shteti autoritar, kishte pak gjasa që ai të dilte jashtë kornizave të trajtimit të problemeve, vetëm në aspektin teknik dhe atë profesional. Një nga çështjet që hapi diskutime në opinionin arsimor të kohës ishte ajo, në se ishte oportune fillimi i një reforme të re, kur jo shumë larg në kohë ishte ndërmarrë ajo për “Riorganizimin e shkollës”. Kjo e fundit vazhdonte ende dhe nuk dihej se deri në çfarë shkalle rezultatet e saj ishin të qëndrueshme. Në se po, problemet e pazgjidhura të kësaj të fundit si do të shkriheshin brenda reformës së re, dhe cilat do të ishin raportet midis tyre.

I diskutueshëm mbetej edhe fakti se deri në ç’masë opinionin shoqëror në përgjithësi dhe, ai arsimor në veçanti që deri më tani kishin shpenzuar jo pak energji, do të ishin në gjendje të përballonin këtë proces, çfarë kosto materiale dhe financiare duhej llogaritur dhe mbi të gjitha, cilat do të ishin rrjedhojat mbi veprimtarinë e shkollës dhe të shoqërisë shqiptare të kohës. Pavarësisht nga të gjithë këto, drejtuesit e PPSH-së e konsideruan më se të përshtatshëm momentin për fillimin e procesit “transformues” të të gjithë sistemit të edukimit dhe, “kryerjen e një hopi të ri dhe të thellë cilësor në zhvillimin e shkollës”²⁷.

²⁵ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej F.) 14, viti (më tej: V.). 1968, dosja (më tej: D.) 5, fl. 36.

²⁶ Kongresi V-të i PPSH, f. 151-152.

²⁷ M. Shehu, “Mbi konkluzionet e diskutimit...”, fl. 25-27.

2. Mësuesit dhe nxënësit në pragun e reformës

Në përpjekjet për zbatimin e reformës së re arsimore, elementët mësues dhe nxënës mbeteshin tepër të rëndësishëm. Para së gjithash, zhvillimet e kësaj periudhe në fushën e shkollës që konsistuan në vendosjen gjithnjë e më të plotë të saj mbi bazat e ideologjisë marksiste-leniniste, kërkonin një angazhim të plotë të të gjithë mësuesve. Procesi i ndryshimeve erdhi duke u thelluar. Koncepti i PPSH në këtë fushë mbështetej në parimin leninist që, orientimi politik i një shkolle, fati i një programi varej “tërësisht dhe ekskluzivisht nga përbërja e lektorëve, e pedagogëve dhe e mësuesve”²⁸. Por nga ky këndvështrim, për të ishte më se e qartë se “pa revolucionarizimin e mësuesit” dhe rritjen e predispozicionit të tij për t’u përfshirë në ndryshime, rezultatet e këtij procesi nuk mund të ishin të garantuara. Në këto kushte, shteti totalitar u tregua i prirur të shfrytëzonte maksimalisht hapësirat e krijuara, duke synuar që herët a vonë me bindje apo me forcë, mësuesit e “vjetër” dhe ata “të rinj” jo vetëm të pranonin politikat e tij, por të bëheshin “përçuesit” e saj tek nxënësit dhe më gjerë, në të gjitha shtresat e popullsisë. Me gjithë përpjekjet e bëra, deri në këto vite edukimi politik i mësuesve mbeti një çështje e vështirë. Niveli i zgjidhjes së tij qëndronte ende larg synimeve të udhëheqjes së vendit.

Për sa i takon rinisë shkollore, sipas konceptit të udhëheqjes komuniste ajo duhej të bëhej një pjesëmarrëse aktive e procesit të çlirimit të shkollës, nga “mbeturinat dhe ndikimi i shkollës e pedagogjisë borgjeze-revizioniste”. Gjithnjë sipas saj, ndryshimet në këtë frymë do të influenconin ndjeshëm mbi procesin mësimor-edukativ, mbi shfaqjet e formalizmit, verbalizmit, metodave konservatore e patriarkale të edukimit. Rritja e personalitetit të nxënësve dhe i peshës së organizatave rinore në jetën e shkollës, duhej të kthehej në një prioritet.

Në raport me vitet e para të pasluftës, ku kontributi dhe pesha e organizatave rinore ishte i dukshëm, do të vërehej një periudhë “qetësie”. Por, klima e re politike e krijuar në mesin e viteve 60-të, si rrjedhojë e strategjisë së “ndryshimeve” të ndërmarra nga PPSH, do të stimulonte ridaljen e rinisë si një faktor i rëndësishëm në jetën e shoqërisë shqiptare. Në këtë proces ajo shfrytëzoi faktin që nga pikëpamja e origjinës shoqërore, tashmë rinia shkollore dhe studenteske ishte më homogjene.

²⁸ *Arsimi Popullor*, viti 1968, nr. 3, fl.8. “Nga diskutimi i Ministrit të Arsimit Th. Deliana në aktivin kombëtar të arsimit”.

Në saje të politikave të ndjekura, shumica e të rinjve ishin me origjinë dhe gjendje familjare punëtore e fshatare kooperativiste. Parë nga ky aspekt, kjo pjesë e rinisë bëhej gjithnjë e më e lidhur dhe e motivuar politikisht nga PPSH. Kjo e fundit mbetej vazhdimisht e interesuar për të ruajtur e forcuar influencën e saj mbi shtresën më të gjallë të popullsisë.

Organizatave rinore vepronin prej vitesh, si organizma politike ndihmëse për edukimin komunist të rinisë shkollore, mbi bazën e një rregulloreje e statuti të tyre, por natyrisht të drejtuara nga partia. Duke i ardhur në ndihmë shkollës dhe mësuesit për realizimin e këtij edukimi, ato në vija themelore e zhvillonin veprimtarinë konform rregullave të shkollës dhe parimit të drejtimit unik të saj. Rezultatet e përfuara në këtë fushë nuk u përgjigjeshin objektivave të vëna nga drejtuesit e PPSH. Sipas tyre, procesi kishte hasur në dobësi e shformime.

Mësues dhe edukatorë mjaftoheshin me organizimin e aktiviteteve të përgjithshme masive kryesisht me karakter zyrtar dhe, në marrëdhënie me nxënësit shpesh vendosnin kontrollin mbi veprimtarinë e këtyre të fundit. Kjo çonte në ndrydhje të energjisë “të iniciativës dhe të vetëveprimtarisë”, si do të shprehej lidhur me këtë çështje personaliteti i arsimit, H. Beqja. Raporte të tilla nuk vonin të vendoseshin edhe midis mësuesve dhe kolektivave të nxënësve. Shfaqja më e dukshme ishte ajo e “rekomandimeve” dhe e “urdhrave”, që çonte në vendosjen e tutelës në fushën edukative²⁹.

Në lidhje me problemin e marrëdhënieve shkollë-organizatë, i ngritur me forcë në këtë periudhë sidomos nga shtypi i specializuar, shfaqeshin dy tendenca, indiferentizmi dhe mosinteresimi nga njëra anë i organizatave rinore dhe nga ana tjetër, tutela e shkollës apo e mësuesve “mbi veprimtarinë e organizatave”³⁰. Rëndom në mbledhjet e të rinjve merreshin parasysh sugjerimet e mësuesve që, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi i drejtonin ato. Më e theksuar tutela shfaqej mbi organizatat e pionierit. Të gjitha këto dukuri mendohej se kufizonin “iniciativat” e nxënësve dhe veprimtarinë e tyre të pavarur.

Në këto kushte, do të intensifikohen përpjekjet e PPSH, për të siguruar mbështetjen e plotë të rinisë shkollore dhe përfshirjen aktive të organizatave të saj në ndryshimet e pritshme të shkollës shqiptare.

²⁹ Hamit Beqja, “Lufta në të dy krahët, kundër indiferentizmit dhe kundër tutelës” në: *Mësuesi*, 23 korrik 1965, fl. 2-3.

³⁰ Po aty.

Brenda këtij synimi ajo do ta shihte në një këndvështrim tjetër ruajtjen e ekuilibrave në marrëdhëniet mësues-nxënës dhe më gjerë, ato shkollë-organizata. Nga njëra anë, nëpërmjet organizatave rinore të shndërruara tashmë në leva të partisë, procesi do të bëhej më i kontrollueshëm dhe, nga ana tjetër, “kujdesi” i kësaj të fundit për të kanalizuar energjinë në kahjen e duhur, evitonte “shpërthimet rinore” e daljen e procesit jashtë “shinave”.

Ngritja e problemit në një moment të tillë duket se u nxit edhe nga fakti se vëreheshin paqartësi, lidhur me vendin dhe rolin e mësuesit në shkollë e organizatat rinore. Në fillimin e vitit 1966 jo shumë larg nga mbajtja e fjalimit në gjimnazin “Qemal Stafa”, Enver Hoxha do të zhvillojë një bisedë me drejtues të rinisë. Shkak me sa duket u bë një artikull i gazetës “Zëri i Rinisë” i datës 19 shkurt 1966, titulluar “Organizata e rinisë dhe shkolla”. Ajo çka shqetësonte udhëheqjen e PPSH dhe vlerësohej si e pa tolerueshme ishte fakti se, në thelb artikulli godiste publikisht jo vetëm të metat e strukturave arsimore, por një parim bazë, atë të drejtimit unik të shkollës. “Ky është një parim themelor, demokratik, socialist, - do të thuhej gjatë bisedës, - i politikës sonë arsimore që siguron karakterin e plotë e konsekuent shtetëror të shkollës sonë dhe drejtimin e saj nga Partia”³¹.

Duke e shtjelluar më tej problemin, Enver Hoxha do të shprehej pa ekuivoqe se, përgjigja e pyetjes se kush është ngarkuar me detyrën e edukimit të rinisë shkollë, do të ishte “që shkolla është institucioni kryesor për edukimin e rinisë shkollë, kurse organizata e rinisë duke u bazuar në parimet politike të drejtimit të shkollë sonë socialiste, e mbështet dhe e ndihmon atë”³². Duke bërë një parantezë lidhur me faktin se drejtimi unik nuk kishte qëllim të prekte “pavarësinë e organizatës së rinisë” pasi, si shkolla ashtu edhe organizatat kishin “interesa themelore të përbashkëta”, ai do të kërkonte nga këto të fundit të rritnin “vigjilencën”, kur konstatohej diçka jo e mirë apo kur mësuesi dhe shkolla jepnin “udhëzime që kapërcejnë kompetencat e tyre”³³. Kjo nënkuptonte se në këto çështje, nuk do të tolerohej asnjë shmangie nga vija e përcaktuar nga lart dhe se, organizatave rinore u jepej më tepër “liri

³¹ Enver Hoxha, “Shkolla dhe organizata e rinisë ka interesa themelore të përbashkëta”, nga biseda me drejtues të KQ të BRPSH, 21 shkurt 1966, në *Vepra*, vëll. 31, Tiranë: “8 Nëntori”, 1980, f. 297.

³² Po aty, f. 299.

³³ Po aty, f. 309.

e vetëveprim”. Në bashkëpunim me ato të partisë, këto të fundit do të vazhdonin të ishin mbështetja kryesore për të thelluar procesin e “revolucionarizimit” të shkollës.

Probleme të marrëdhënieve mësues-nxënës filluan të prekin faqet e shtypit. Në artikuj të shumtë të kësaj periudhe, duke u fokusuar në rolin e mësuesit do të kërkohej që, ai të lidhej më ngushtë me nxënësit dhe organizatat rinore. “Por ky bashkëpunim, dhe kjo ndihmë, - do të thuhej në njërin prej tyre -, duhet të mbështetet në parime të drejta organizative dhe pedagogjike, të mos cenonjë dhe të mos ndrydhin iniciativën dhe veprimtarinë e tyre, por përkundrazi ta nxisin dhe ta inkurajojnë atë”³⁴. Realisht ajo që në thelb synonte PPSH ishte që, nëpërmjet vendosjes së raporteve të reja midis mësuesve e nxënësve të rriste vendin e këtyre të fundit dhe organizatave rinore në jetën e shkollës dhe më gjerë, në jetën politike e shoqërore. Pjesëmarrja aktive e rinisë në përgjithësi dhe asaj shkollë në veçanti në “aksionet” politike dhe ideologjike të kohës, u konsiderua nga ajo si rruga më efikase në thellimin e procesit të edukimit komunist³⁵.

Në këtë kuadër u ushqyen dhe nxitën “iniciativa” të shumta që kapërcyen muret e shkollës. Arsyeja e një qëndrimi të tillë shpjegohet me faktin se, me ndryshimet e filluara për “revolucionarizimin e mëtejshëm të vendit”, udhëheqja komuniste bëhej veçanërisht e interesuar të ruante mbështetjen e rinisë në gjithë këtë proces, ta përdorte ashtu si edhe e përdori, duke i “kanalizuar” energjitë e saj atje “ku duhej”. Viti 1967 ishte i mbushur me “iniciativa” dhe “lëvizje revolucionare”. Më radikalja do të ishte ajo kundër botëkuptimit fetar dhe zakoneve patriarkale, ku rinia shkollë u gjend në rolin e “promotorit”. Si pikënisje e lëvizjes u konsiderua “iniciativa” e filluar nga të rinjtë e shkollës së mesme “Naim Frashëri” në Durrës. Për të kuptuar se çfarë ndodhi në një kontekst më të gjerë e më të plotë, është e nevojshme një analizë nga këndvështrime të ndryshme i thelbit të kësaj “lëvizjeje” dhe rrjedhëve të saj në jetën e shkollës e të shoqërisë shqiptare të kohës.

Sipas variantit zyrtar ajo zuri fill në janarin e vitit 1967. Komiteti i Rinisë i shkollës së mesme “Naim Frashëri” të Durrësit natën e 21 janarit,

³⁴ Hamit Beqja, “Forcimi i edukimit ideopolitik – Detyra themelore e shkollës”, në: *Arsimi Popullor*, viti 1966, nr. 2, fl. 32.

³⁵ *AQSH*, F. 14, V. 1967, D.8, fl. 1-2. Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH, mbajtur në mbledhjen e dt. 22.04.1967, Mbi disa çështje të edukimit ideopolitik të rinisë dhe orientimi për Kongresin e V-të të saj.

organizoi një mbledhje “luftarake”, si do të cilësohej nga shtypi i kohës, me 20 aktivistë të parë, që ndërmorën “nismën” për të luftuar “ideologjinë fetare, bestytnitë dhe zakonet prapanike”³⁶. Një ditë më vonë ambienti i shkollës u gjend i mbushur me parulla dhe citate, që “fshikullonin ideologjinë fetare”. E gjithë organizata e rinisë njoftohej për pjesëmarrjen në një mbledhje mjaft të rëndësishme me temë: “Të luftojmë deri në fund ideologjinë fetare”. Prej saj dolën edhe strukturat e para, që do të organizonin dhe ndiqnin vijimësinë e lëvizjes. Fillimisht u ngrit “Shtabi revolucionar kundër ideologjisë fetare” dhe tre komisione me funksione të ndryshme; ai i “propogandës”, i “mbledhjes së citateve dhe literaturës” si dhe “komisioni i kontrollit të figurave në qytet dhe në shtëpi”. Kohë më vonë shtabi revolucionar, që të kujtonte shtabet e ngritura gjatë revolucionit kulturor kinez, ndryshoi emërtimin në “Komisioni i luftës kundër ideologjisë fetare dhe zakoneve prapanike”³⁷.

Si do të pohohej vitet e fundit nga R. Alia, i cili vazhdonte t’i përmbahej versionit zyrtar, lëvizja u fillua nga të rinjtë e kësaj shkolle. Në janarin e vitit 1967 ata i ishin drejtuar me një letër KQ të PPSH, ku e vinin në dijeni për “nismën” e tyre. Gjithnjë sipas tij, pas një farë “hezitimi” letra iu dorëzua Enver Hoxhës³⁸, i cili hapi dritën jeshile që do t’i jepte dora-dorës lëvizjes të drejtën “e qytetarisë”. “..... U desh vetëm një shkëndi e lëshuar nga nxënësit revolucionarë të shkollës “Naim Frashëri” në Durrës, do të deklaronte ai më vonë, të frymëzuar nga mësimet e Partisë, që të ndizej ai zjarr i madh që fshiu nga faqja e dheut vatrat e obskurantizmit fetar”³⁹.

Në 2 shkurt të po këtij viti “shtabi revolucionar” mobilizoi të rinjtë të cilët iu drejtuan manastirit të Shënnavlashit të ndodhur në rrethinat e Durrësit dhe, në bashkëpunim edhe me të rinjtë e këtij fshati, vendosën ta “kthejnë” në institucion kulturoro-shëndetësor. Ata që tentuan të bënin

³⁶ “Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së parties kundër ideologjisë fetare, paragjykimeve, bestytnive e zakoneve prapanike”, *Zëri i popullit*, 8 shkurt 1967.

³⁷ Astrit Hoxha, Lazam Koldashi, “Inisiativa revolucionare e shkollës sonë. Sukseset e gjertanishme dhe perspektiva e saj”, në: *Arsimi Popullor*, viti 1967, nr. 2, fl. 18.

³⁸ Ramiz Alia, *Unë Ramiz Alia dëshmoj për historinë*, (botim i dytë), Tiranë: “Dituria”, 1993, fl. 67-68.

³⁹ Enver Hoxha, *Raporte dhe fjalime 1967-1968*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1969, fl. 206.

një farë rezistence, shumë shpejt u gjendën para bankës të të akuzuarve⁴⁰. Më 8 shkurt 1967, vetëm dy ditë pas fjalimit “të famshëm” të Enver Hoxhës kundër fesë dhe zakoneve prapanike, e përditshmja më e rëndësishme e kohës “Zëri i popullit”, do të bënte publike fillimin e saj me kryeartikullin e titulluar “Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë kundër ideologjisë fetare, paragjykimeve, bestytnive e zakoneve prapanike”. Kaq u desh që feja dhe institucionet fetare të gjendeshin tashmë në epiqendrën e “tërmetit”, vala goditëse e të cilit u përhap në mënyrë marramendëse. Ajo çoi në shuarjen e të gjitha institucioneve e praktikave fetare. Ky ishte hapi i parë në bërjen e Shqipërisë, vendin e parë dhe të vetmin ateist në botë, gjë që u sanksionua përfundimisht me Kushtetutën e vitit 1976.

Vite më vonë një bashkëkohës, duke sjellë në kujtesë flakën antifetare që përfshiu vendin, do të shkruante se “... kush i ka jetuar këto vite i mban mend patjetër ato turma njerëzish që drejtoheshin drejt institucioneve fetare, ata klerikë të struktur që detyroheshin të braktisnin vendet e shenjta dhe gërmadhat e kishave dhe xhamive të shkatërruara”⁴¹. Gjatë këtij procesi si do ta përshkruante një autor i huaj, klerikët e besimeve të ndryshme u detyruan të pranonin “keqbërësitë e tyre në sy të popullit të mbledhur” dhe “t’i njihnin gabimet e tyre”, duke kërkuar “një rikonvertim në frontin e prodhimit”⁴².

Një pyetje që mund të bëhej në këtë rast do të ishte se si shpjegohej që, lëvizja mori një shtrirje të shpejtë dhe kaq të gjerë. Për studiuesin e filozofisë të sistemeve politike A. Fuga “eliminimi i lirisë fetare kryhet në një atmosferë lirie dhe lehtësime kolektiv” dhe, se “shpjegimi që mund të jepet për sa i përket bashkimit masiv të turmave me të rinj dhe të reja në shumicën e rasteve, rreth qëllimit për të vendosur një ateizëm rrënjësor” do të ishte se “kryesisht në fshat, tek feja mbështeteshin disa tradita shumë të prapambetura, patriarkale që shtypnin rininë dhe gratë. Kështu me mijëra të rinj dhe gra shihnin tek lufta kundër institucioneve dhe praktikave fetare, një mjet të efektshëm për t’i shpëtuar zgjedhës

⁴⁰ Kozma Grillo, “Aksioni i madh ideologjik me përmbajtje të tillë revolucionare i të rinjve të shkollës “Naim Frashëri” të Durrësit, *Mësuesi*, 10 shkurt 1967, fl. 1-4.

⁴¹ Agim Mero, *Vitet e ëndërrave të vrara*, Tiranë: “Dritëro”, 1998, f. 75.

⁴² E. Gënar, *E paharrueshmja...*, f. 33.

patriarkale”⁴³. Duke i shtuar indoktrinimin sidomos të të rinjve, me ideologjinë marksiste-leniniste mendojmë se bëhet më i qartë fakti se pse u përfshinë në këtë lëvizje, një pjesë e mirë e tyre.

Një çështje e diskutueshme mbetet ajo në se, vërtet u fillua “nga poshtë” apo rinia u vu në rolin e “nismëtarit”. Nisur nga analiza e dokumentacionit të periudhës, do të ishte naivitet të mendohej se lëvizja lindi papritmas në një ditë të bukur. Është i njohur fakti se rinia dhe organizatat e saj drejtoheshin nga PPSH dhe se, ajo gjendej gjatë gjithë kohës nën trysninë e një veprimtarie të gjatë e të fuqishme antifetare. Pas lufte, shteti komunist kishte ndërmarrë një sërë aktesh ligjore e nënligjore që kufizonin veprimtarinë e klerit në vend, e shoqëruar kjo me një propagandë të fuqishme ateiste, ku shkolla padyshim luante rolin kryesor. Por nga ky këndvështrim duket e bazuar ideja që kjo lëvizje, u realizua në një terren të mirëpërgatitur.

Pavarësisht “rezultateve pozitive për dobësimin e bazave të klerit”, deri në këtë periudhë, ato do të konsideroheshin nga PPSH të pamjaftueshme dhe një rrezik “potencial”. Në këto kushte, kjo e fundit mendonte se kishte ardhur momenti për t’i dhënë një goditje përfundimtare që “iu besua” rinisë, duke përfituar nga entuziazmi dhe pafajësia e moshës. “Nuk ka dyshim, - do të tërhiqte vëmendjen studiuesi perëndimor Peter Prifti lidhur me këtë proces, - që pjesa më e madhe e zemërimit ishte foshnjëror. Gjithsesi, format që ai mori dhe objekti i sulmit ishin të kontrolluara në mënyrë strikte nga lart, për të përmbushur objektivat e regjimit”⁴⁴.

Në njoftimin e parë për fillimin e lëvizjes, në gazetën “Zëri i popullit” të datës 8 shkurt, duke shtruar pyetjen se pse “Komiteti i Partisë i rrethit të Durrësit ja besoi këtë aksion rinisë shkollore”, sillet si argument fakti se “në vetvete rinia është më e zhveshur nga këto mbeturina, bestytni fetare e zakone prapanike”⁴⁵. Sigurisht kjo ishte një e vërtetë, por ky pohim në të njëjtën kohë konfirmonte faktin se lëvizja u nxit nga strukturat partiake lokale, të cilat s’duhet harruar se nuk bënin asgjë pa

⁴³ Artan Fuga, *Shtigjet drejt guvës së gjarpërit (“Mbi filozofinë e sistemeve politike”*, Tiranë: “Ora”, 2001, f. 81.

⁴⁴ Peter Prifti, *Remote Albania. The politics of isolation*, Tiranë: “Onufri”, 2000, f. 23-24.

⁴⁵ Xhelil Gjoni, “Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë kundër idologjisë fetare, paragjykimeve, bestytnive dhe zakoneve prapanike”, në: *Zëri i Popullit*, 8 shkurt 1967, f. fl.1-2.

udhëzime nga qendra e partisë. Si do të kujtonte më vonë drejtuesi më i lartë i rinisë të asaj periudhe, Agim Mero, këto të fundit ishin “entuziastë” madje “më entuziastë se vetë nxënësit” për këtë lëvizje⁴⁶. Në një farë mënyre rinia u orientua për të ndërmarrë veprime “konkrete”. “Nën udhëheqjen e organizatës bazë të Partisë, do të thuhej në një artikull të gazetës “Mësuesi” të datës 10 shkurt, Shtabi revolucionar kundër ideologjisë fetare, paragjytimeve, bestytive e zakoneve prapanike, duke mos i konsideruar të rinjtë si axhami, por duke patur besim të plotë tek ato, i hodhi në këtë aksion të madh ideologjik”⁴⁷.

Paradoksi qëndron në faktin se nga shteti komunist vazhdimisht është këmbëngulur se, ajo ishte një lëvizje e filluar nga vetë rinia, kur në shtypin e kohës gjenden prononcime kontradiktore që në mos provojnë të kundërtën, të bëjnë të dyshosh për vërtetësinë e tyre. Gjithsesi pavarësisht nga u fillua i rëndësishëm mbetet fakti që ajo ishte një lëvizje me synime të qarta politike. “Iniciativa që kur lindi, nuk ishte një qëllim në vetvete, por pati objektiva të caktuara nga Partia – do të tërhiqte vëmendjen gazeta “Zëri i Popullit”. - Ajo po vërteton se aksioni është mjet shumë i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit kryhet revolucionarizimi jo vetëm i rinisë, por, i gjithë punonjësve”⁴⁸.

Në mënyrë eksplicite këto synime shpalosen në një sërë artikujsh të shtypit, vetëm pak ditë pas fillimit të lëvizjes. Në njërin prej tyre do të tërhiqej vëmendja se qëllimi i saj konsistonte para së gjithash, në thyerjen e akullit të “indiferentizmit dhe qëndrimit ndaj fesë dhe shfaqjeve të shëmtuara të saja, ndaj të gjitha shfaqjeve të tjera të huaja, të çfarëdo natyre që të ishin ato” që, të ngrihej “masa e të rinjve shkollorë dhe punëtorë si dhe gjithë masat e tjera punonjëse në luftën kundër ideologjisë fetare dhe të mbylleshin me rrugë revolucionare nga poshtë, qendrat e obskurantizmit fetar”⁴⁹. E gjithë kjo lëvizje e drejtuar fillimisht kundër ideologjisë fetare, e shtriu sferën e veprimtarisë duke depërtuar në problemet e shkollës dhe, futur frymën “e aksionit” në gjithë jetën e saj.

Reagimi i strukturave më të larta arsimore ishte i shpejtë. Disa ditë më pas, iniciativa e shkollës “Naim Frashëri” të Durrësit, do të bëhej

⁴⁶ A. Mero, *Vitet e ëndërrave ...*, f. 75.

⁴⁷ Kozma Grillo, “Aksioni i madh ideologjik me përmbajtje të thellë revolucionare e të rinjve të shkollës “Naim Frashëri” të Durrësit, në: *Mësuesi*, dt. 10 shkurt 1967, fl. 1-4.

⁴⁸ Xh. Gjoni, *Me shpatën ...*, fl.2.

⁴⁹ A. Hoxha, L. Koldashi, “Iniciativa revolucionare...”, fl. 5.

objekt i analizës së tyre. Në konkluzionet e zv. Ministrit të atëhershëm të Arsimit, H. Duma do të konfirmohej se, ajo duhej përkrahur plotësisht dhe vlerësuar duke porositur “të gjitha shkollat dhe organet e arsimit ta çojnë atë më tej, në gjerësi dhe thellësi”⁵⁰. Në një burim tjetër të kohës do të thuhej se mësuesit dhe drejtuesit e shkollave jo vetëm duhej “ta mbështesnin” pa rezerva por të bënin kujdes që “... të mos ia lidhnin duart vetes pas rregulloreve e normave tradicionale të deritanishme”, por të vepronin me iniciativë⁵¹. Sipas mendimit zyrtar, efekti më pozitiv i kësaj lëvizjeje që doli jashtë mureve të shkollës, konsistonte në forcimin e lidhjeve midis edukimit “në shkollë me edukimin në shoqëri, me luftën klasore ideologjike që zhvillohet në të”⁵². Ky ishte edhe thelbi i politikës e strategjisë së PPSH, në fushën e edukimit komunist të rinisë.

Kjo lëvizje me karakter të theksuar politik shpejt do të pasohej nga të tjera, si ajo e shkollës “Partizani” të kryeqytetit, e fokusuar në çështjen e marrëdhënieve mësues-nxënës. “Iniciativa” e drejtuar kundër koncepteve “të vjetra” dhe ndikimeve “të pedagogjisë borgjeze” mbi “papekshmerinë e autoritetit pedagogjik të mësuesit”, rriti trysinë mbi mësuesit dhe shkollën. Si do të përshkruhej më vonë, në një artikull botuar në gazetën “Mësuesi” të dt. 23 qershor 1967, pikënisja e saj ishte qëndrimi “burokratik” i drejtuesve të shkollës, dhe njëheri qëndrimi “indiferent” i Këshillit Pedagogjik ndaj organizatës së rinisë. Të dy këto fenomene u vunë në qendër të kritikës, nëpërmjet fletë-rrufeve aq të njohura në këtë periudhë. Paskëtaj, do të vijohet në këtë artikull “në shkollë filloi një hov i ri kritikash në dy drejtime nga poshtë lart dhe kritika paralele”⁵³.

Kjo lëvizje ashtu si edhe mjaft të tjera të zhvilluara në kuadrin e “revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës”, u përkrahën dhe nxitën nga strukturat partiake. Në shtatorin e vitit 1967 sektori i edukimit pranë KQ të PPSH, në një udhëzim dërguar komiteteve të partisë të rretheve dhe drejtorive të shkollave do të kërkonte që, këto lëvizje “revolucionare”

⁵⁰ Hasan Duma, “Mësuesit të përkrahin, të ndihmojnë dhe të çojnë përpara iniciativat revolucionare të nxënësve, në: *Mësuesi*, dt. 24 mars 1967, fl. 1-2.

⁵¹ Po aty.

⁵² *AQSH*, F.14, V. 1967, D. 206, fl. 98-99, shkresa nr. 760, dt. 6109/1967. “Mbi iniciativat revolucionare në shkollë dhe detyrat tona për t’i përkrahur, për t’i thelluar dhe çuar më tej”.

⁵³ Arian Shehu, Ilir Vullkaj, “Aksioni ynë, përgjegjësia jonë”, *Mësuesi*, dt. 23 qershor 1967, fl. 3.

të rinisë të konceptoheshin si “... pjesë përbërëse të lëvizjes së gjithanshme revolucionarizuese të vendit”⁵⁴.

Si do të pranohej haptazi në një nga mbledhjet e Byrosë Politike të KQ të PPSH, ato “janë mbështetur dhe inkurajuar nga organizatat e partisë”, të cilat e shihnin me optimizëm faktin që “me guxim si asnjëherë tjetër, janë bërë nga rinia e shkollave kritika të drejta për problemet e shkollës, për mësuesit dhe drejtuesit”⁵⁵, që këto organizata duhej të rritnin vigjilencën sepse, krahas përkrahjes ishin vërejtur edhe “ngurrime” nga mësues apo drejtues shkollash” me pretekstin - si do të thuhej në material - e ruajtjes së autoritetit të tyre”. Porosi e radhës do të ishte që “fryma e guximit që është krijuar tani, për të thënë haptazi atë që mendon rinia” duhet inkurajuar dhe duhej përdorur si një mjet i rëndësishëm “për forcimin e revolucionarizimitin e veprimtarisë dhe të jetës së organizatës”⁵⁶.

Por cili ishte reagimi i masës së mësuesve. Në momentet e para ato u gjenden shpesh të papërgatitur e pse jo të frikësuar dhe shokuar. Synimi i lëvizjeve të nxënësve të shpërthyer në këtë periudhë, - si do të thuhej në një burim të kohës, - ishte që, “revolucionarizimi i mësuesve të realizohej nga poshtë, gjë që nënkuptonte që fjalën për mësuesin dhe punën e tij në shkollë ta thoshin vetë nxënësit”⁵⁷. Shtimi i kompetencave të organizatave rinore në procesin mësimor-edukativ, përpos efekteve në thellimin e “demokracisë” së brendshme dhe vendosjen e raporteve më të mira midis mësuesve dhe nxënësve, pavarësisht si u motivua, jo rrallëherë preku autoritetin e mësuesit.

“Tashti nxënësit kritikojnë këdo, - do të thuhej në një artikull të gazetës “Mësuesi” të kësaj periudhe, - asnjëri nuk i shpëton kontrollit të masës dhe asnjëri nuk mund të kalojë pa dhënë llogari tek masat për punën e tij. Të gjitha këto kanë sjellë në revolucionarizimin e mësuesit, të koncepteve të tija, të rishikimit dhe rivlerësimit të punës së tij, nga pozita të tjera shumë më të shëndosha ideologjike”⁵⁸. Në kushtet kur inkurajimi

⁵⁴ AQSH, F.511, V.1964, D. 206, fl. 98, shkresa 760, dt. 6.09.1964, “Mbi iniciativat revolucionare në shkollë dhe detyrat tona për t’i përkrahur, për t’i thelluar dhe çuar më tej”.

⁵⁵ *Po aty*, F. 14, V. 1967, D. 8, fl. 14-15. Nga mbledhja e Byrosë Politike të KQ të PPSH, dt. 22.04.1967.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 15.

⁵⁷ A. Hoxha, L. Koldashi, “Inisiativa revolucionare...”, fl. 25.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 25-26.

i kritikës “nga poshtë” kishte arritur nivelet më të larta dhe kur, gjithkujt i jepej e drejta të ndërhynte në jetën dhe punën e tjetrit, mësuesit u gjendën nën presion. Për t’iu shmangur “valës goditëse” dhe mos u bërë objekt i “kritikës të hapur” apo edhe i “masave edukuese”, një pjesë e mësuesve, sidomos i atyre që punonin në kategoritë më të larta arsimore, u bënë më të kujdesshëm dhe pse jo më të tërhequr.

Strukturat partiake dhe ato shtetërore, do të intensifikonin veprimtarinë e tyre në drejtim të nxitjes dhe përkrahjes të çdo “nisme”, - si do të thuhej në një udhëzim të kësaj periudhe, - që do të kontribuonte “... për revolucionarizimin e gjithanshëm të shkollës, në radhë të parë për revolucionarizimin e vetë mësuesve, për ta transformuar akoma më shpejt botëkuptimin e tyre, për t’i bërë ato akoma më shumë njerëz politikë në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale, për t’i lidhur akoma më ngushtë me jetën dhe me aktualitetin ...”⁵⁹

Dashur pa dashur me thellimin e procesit, masa e mësuesve u gjend e përfshirë duke u bërë pjesë e reformës. Efektet e saj pa dyshim ishin të rëndësishme dhe lanë pasojë në gjithë ecurinë e mëtejshme të shkollës. Duke i hapur rrugën përsosjes së sistemit arsimor e “radikalizuar” përmbajtjen socialiste, reforma për “Revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës” shërbeu si, një nga mekanizmat e rëndësishëm për indoktrinimin e gjeneratave të reja dhe më gjerë, të mbarë shoqërisë shqiptare të kohës me ideologjinë komuniste.

S u m m a r y

THE BEGINNINGS OF “REVOLUTIONIZING” THE ALBANIAN SCHOOL SYSTEM (1966-1967)

During the mid 1960’s the Albanian school system underwent a new reforming, which was designed by the totalitarian regime based on more aggressive and more determined strategies to deepen the schools’ socialist patterns. In this context, the “changes” took an absolute character affecting every aspect of the schooling process which became subject to a complete “review” in accordance with the Marxism-Leninism philosophy. Although the

⁵⁹ *AQSH*, F. 490, V. 1967, D. 503, Material i sektorit të edukimit për KQ të PPSH, nr.273, dt. 5.04.1967, fl. 2.

Albanian leadership never admitted it, these changes were directly influenced by the Chinese Cultural Revolution. Being certainly the fundamental institutions of education, the schools became inextricably involved in the vortex of this “revolution”.

In November 1966, was held the Fifth Congress of the Albanian Labor Party, which among other things established the mainstream strategies for the country’s education system. In this Congress was set as a future priority the deepening of the socialist character in schools. The teachers and pupils would continue to be considered as the primary elements in implementing this new education reform. The state aimed at exploiting every means available in order to make the teachers, sooner or later, willingly or not, obey its policy. As far as the youth was concerned, the changes made in schools were controlled through the youth organizations that had already become Party’s instruments, and the energy of this group of the society was “disciplined” and made sure to be on the appropriate side.

The active participation of the youth in the political and ideological activities of the time was considered to be the most efficient way in strengthening the communist education. In this context, there were supported and promoted various “initiatives” that went beyond the schools’ premises, the most radical of which would be the one against religious beliefs and patriarchal traditions. In this case, the youth was considered to be the “initiator”. As a starting point for this movement was the “initiative” that started by the youngsters of the “Naim Frasheri” High School, in Durres. Religion and religious institutions were in the center of this “earthquake” which caused a devastation that spread with an astonishing speed. As a result all the religious institutions were closed and all the religious practices were forbidden. This was considered to be the first step towards making Albania the first and the only atheist country in the world, a fact eventually sanctioned in the Constitution of 1976.

This movement that initially targeted religion, eventually involved the whole school system, introducing the concept of “volunteer work” in every aspect of the schools’ activity. Willingly or not teachers and pupils had become part of the reform to “further revolutionize the school”, a means that later on would result one of the most important in indoctrinating the new generations and, in turn, the whole Albanian society of the time, with the communist ideology.